

RELACION TEKNIK

Ky relacion pershkruan situaten aktuale dhe perpjekjen per nje zgjidhje konstruktive emergjente te shkolles 9-vjecare Vithkuq.

Me kerkesen e Bashkise Korce kemi inspektuar kete object ne Vithkuq i cili ndodhet ne keto kordinata KRGJSH: X=549749.372 / Y=4487768.037

Gjate inspektimit kemi konstatuar se ne dyshemene dhe muret e katit perdhe ka pasur plasaritje dhe dukej se kjo vinte nga ulja e fasades kryesore. Duke konstatuar kete ulje kemi marre ne konsiderate per te vezhguar nese ka rreshqitje te terrenit te zones ku ndodhet objektit duke vezhguar nese objektet afer kane probleme te tilla. Nga ky vezhgem siperfaqesor konstatuam se objektet e tjera nuk kishin shenja te plasaritjeve ose deme te tjera konstruktive. Per kete arsye e lame menjane kete shkak edhe pse mendojme se ndoshta duhet nje vezhgem me I detajuar dhe me professional.



Gjithesesi u perqendruam vetem tek objektit i shkolles dhe shkakut e demtimeve konstruktive ne object eshte local pra qe ka te beje vetem me bazamentin e shkolles i cili per mendimin tone ka pesuar ulje.

Kjo ulje mendojme se mund te kete ardhur nga lengezimi i terrenit per shkak te ujrave nentokesore duke menduar se keto ujra rrisin nivelin kur ka rreshje te medha ose kur bjen debore dhe toka tejngopet me lageshtire, por duke supozuar gjithashtu se mund te kete edhe damare rrjedhjesh ujore ne themelet e objektit.

Prandaj vemendja jone u perqendrua tek masat mbrojtese dhe perforcimi i themelet te fasades kryesore. Gjithashtu theksojme se keto punime duhet te kryhen ne kohe te thate



Per keto arsye menduam se duhet te merren disa masa emergjente te cilat

konsistojne ne:

1. perforcimin e themelit te fasades kryesore (anes lindore te objektit) dhe qe perfshin ndertimin e dy trareve te armuar pergjate themelit te fasades kryesore dhe qe lidhen me trare terthore sipas p;rojektit te paraqitur. Keto punime perfshijne germimet, dhe prishjen e murit te themelit ne permasat e trareve terthore, shtresat e zhavorrit, armimin e trareve dhe betonimin e tyre.
2. ndertimin e drenazhit ne te gjithë perimetrin e objektit punimet e te cilit sic jane paraqitur edhe ne preventiv, konsistojne ne germimin e kanalit dhe vendosjen e tubacionit me brima dhe mbulimin e tij me shtresat e cakellit ne granulometirne e shenuar ne projekt. Duke mos qene ne gjendje te percaktojme sakte rrjedhen e ujrave nentokesore mendojme se eshte e arsyeshme qe ky drenazh te ndertohet ne te gjithë perimetrin e objektit. Nese do te konstatohet ndonje levizje apo shkarje e terrenit eshte e nevojshme qe te vendoset nje rresht pilota por qe ne kete faze nuk eshte parapare ne prjektin tone edhe per arsyet e moskonstatimit te kesaj shkarje te terrenit nga nje vezhgim siperfaqesor qe I kemi bere zones dhe qe e permendem ne fillim te ketij relacioni.
3. duke menduar qe te largojme cdo mundesi qe cdo rrjedhe ujore te zbrese ne themel kemi mednuar se eshte e nevojshme qe te ndertojme te reja systemin e shkarkimit te ujrave te catise dhe lrgimkin e tyre nepermjet tubacioneve pergjate perimeterit te objektit duke ndertuar gjithashtu edhe trotuaret per te rritur sigurine e mbrojtjes se themeleve te objektit nga cdo rrjedhe ujore e mundshme. Te gjitha

detajet e ketyre masave konstruktive jane te detajuara ne projektin dhe preventivit e paraqitur.

Gjithe sa pershkruam me siper eshte per situaten emergjente per te larguar ujrat dhe per te siguruar qendrueshmerine e objektit, por theksojme se ky object ka nevoje per nje rikonstruksion te pergjithshem duke perfshire soletat e nderkateve, catine e re, suvatime, instalimet elektrike dhe hidrosanitare dhe te ngrohjes.

Gjithashtu nga vezhgimet tona del se edhe palestra ka nevoje per rikonstruksion total.

Ing. Gjeto Dukaj
